

**KRITERET E PRANIMIT TË STUDENTËVE NË PROGRAMIN E CIKLIT TË  
PARË TË STUDIMEVE “BACHELOR” PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020  
FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT**

**Programi i studimit Bachelor në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit”**

- Kanë të drejtë të pranohen në programin e studimit të Ciklit të I-rë Bachelor në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit” të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave në fuqi.
- Kandidatët i nënshtrohen konkurimit të Testimit Praktik konform testeve të miratuara nga Senati i UST dhe të shpallura në faqen web të UST.
- Kandidatët që konkurojnë në këtë program studimi, duhet të plotësojnë kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjekësore miratuar nga UST dhe e shpallur në faqen web të saj.
- Kandidatët vlerësohen me pikë të grumbulluara bazuar në Rezultatet e konkursit në testimin praktik të UST-së dhe notës mesatare të shkollës së mesme. Sipas Vendimit Nr.7 datë 18.01.2016 të Senatit Akademik të UST, raporti ndërmjet konkurimit praktik dhe notës mesatare të kandidatit do të jetë në kufijtë 60% me 40%.
- Klasifikimi i kandidatëve bëhet bazuar në sasinë e pikëve totale të grumbulluara, të vendosur në rendin zbritës. Fitojnë kandidatët me numrin më të madh të pikëve të grumbulluara.